

| | |
|---|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KUNOVARE / PUBLIC OF KOSOVO | |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. Dep. Dep. | DPK/DMP |
| Nr. Itaq. Broj. Stavica Nr. gjuha | 02 |
| Nr. Prot. Bi Prot. Prot. No | 03-4393/13 |
| Data Datum Data | 23.12.2013 |

KA.nr.1254/2013

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Zekaj kryetare e Kolegjit, Biljana Rexhiq dhe Dalip Begaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Sebahate Hoti, duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur nga i pandehurit Hajdar Mehmet Loku, nga fshati Kotlinë K. Kaçanik përmes mbrojtësit Selim Idrizi- Avokat, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik-Divizioni i Kundërvajtjes, Regj.nr.2123/2012, të dt. 28.10.2013, në bazë të nenit 31 al.3, 39, dhe nenit 221 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më dt. 29.11.2013, merr këtë:

A K T V E N D I M

NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore Ferizaj-Dega në Kaçanik-Divizioni i Kundërvajtjes, Regj.nr.2123/2012, të dt. 28.10.2013 ashtu që ndaj të pandehurit Hajdar Loku, PEZULLOHET procedura kundërvajtëse, konform të nenit 198 al. 1 pika 7 lidhur me nenin 27 al. 1 të Ligjit për Kundërvajtje, për shkak të parashkrimit relativ të veprës kundërvajtëse.

Nga një kopje të aktvendimi duhet dorëzuar palëve në procedurë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik-Divizioni i Kundërvajtjes, me aktvendim, Regj.nr.2123/2012, të dt. 28.10.2013, të pandehurin Hajdar Mehmet Loku, nga fshati Kotlinë K. Kaçanik e ka shpallur përgjegjës sepse:

Si Zyrtari i Lartë Publik, në pozitën e këshilltarit komunal në Ansamblen Komunal në Kaçanik, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë pranë Agjencisë Kundër Korrupsionit, deri më datën 31.03.2012, me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 par.1 e sanksionuar, sipas nenit 17 paragrafi 1. pika 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lart Publik, për të cilën kundërvajtje ia shqiptoj gjobën në shumë prej 300 (pesëqind) Euro.

Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor, të paguaj shumën prej 5 (pesë) €.

Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Hajdar Loku, nga fshati Kotlinë K. Kaçanik, përmes mbrojtësit, Selim Idrizi-avokat ka paraqit ankesë për shkak të;

-vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe,

-shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse në të cilën përveç tjerash thekson se nuk ka nënshkruar asnjë formularë të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe se njoftimi me emal adres dhe me gojë, nuk mund të merret si bazë për ta shpallur fajtor. Se qëllimi i tij nuk ka qenë shmangeja deklarinimit ose fshehja e pasurisë, por vetëm vonesa ose neglizhenca duke mos e ditur për pasojat e saj.

Propozon që ankesa të aprovohet si e bazuar, aktvendimi i goditur të ndryshohet dhe të shpallet i pafajshëm duke e pezulluar procedurën.

